



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201601596/4

Tiranë ____/____/2016

Lënda : *Rekomandohet marrja e masave për mbështetjen e nevojshme financiare për ndërtimin e Ujësjetës në Fshatin Visokë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia, Mallakastër.*

Drejtuar : **Arben Ahmetaj**
Ministër i Financave

TIRANË

Sokol Dervishaj
Ministër i Transportit dhe Infrastrukturës,

TIRANË

Për dijeni : **K.Sh.H.**
Adresa:

TIRANË

Agron Kapllanaj
Kryetar i Bashkisë,

MALLAKASTËR

Të nderuar zotërinj Ministra!

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka në proces shqyrtimi çështjen që shqetëson komunitetin e banorëve të Fshatit, Visokë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia, Mallakastër, për mungesën e furnizimit me ujë të pijshëm .

Me rastin e prezantimit të kësaj çështjeje prej Komitetit Shqiptar të Helsinkit, pranë Institucionit që unë përfaqësoj, është bërë e mundur kërkitimi i informacionit Kryetarit të Bashkisë, Mallakastër, rreth mundësive të zgjidhjes së kësaj çështjeje si dhe veprimeve të mundshme të kryera për zgjidhjen e saj.

Në përgjigje të kërkesës për dhënie informacioni, Kryetari i Bashkisë, Mallakastës, me shkresën nr.1900/1 Prot, datë 04.11.2016, krahas informacionit të dhënë, kërkon ndërmjetësim dhe ndërhyrje prej Institucionit të Avokatit të Popullit, për mundësimin

e financimit të Projektit *“Furnizimi me ujë të pijshëm të Fshatit Visokë/ Ndërtimi i rrjetit shpërndarës”*.

Në ushtrim të detyrës për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, si dhe nxitjes së standarteve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në parashikimet e ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, ligjin nr. 139/2015, *“Për vetëqeverisjen vendore”*, gjen me vend të ndërhyjë pranë jush për zgjidhjen e çështjes së prezantuar, në kushtet kur njësia e vetëqeverisjes vendore nuk zotëron fondet apo mjetet e mjaftueshme për arritjen e standartit dhe normave kombëtare për furnizimin me ujë të pijshëm.

Referuar parashikimeve të nenit 22/3 të Ligjit nr. 139/2015, *“Për vetëqeverisjen vendore”*, Bashkia, Mallakastër, është përgjegjëse në territorin e juridiksionit të vetë, për prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm, dhe se në kuptim dhe zbatim të parashikimit të kryer në nenin 30/6 të ligjit në fjalë, qeverisja qendrore garanton njësive të vetëqeverisjes vendore, mbështetjen e nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.

Praktika e derisotme për zgjidhjen e çështjeve të tilla, tregon se, në pamundësi të mbështetjes së nevojshme financiare nga Buxheti i Shtetit, Këshilli i Ministrave, rast pas rasti, ka kryer lidhjen e marrveshjeve për financimin e projekteve mbi bazë të të cilave është zgjidhur problemi i furnizimit me ujë të pijshëm i komuniteteve të banorëve në zona të ndryshme të Shqipërisë.

Rasti i prezantuar mund dhe duhet të marrë vemendjen që meriton me qëllim zgjidhjen e çështjes së furnizimit me ujë të pijshëm të komunitetit të banorëve të Fshatit, Visokë, Bashkia, Mallakastër. Mbi bazë të këtij vlerësimi, si përfaqësues i Institucionit të Avokatit të Popullit, në përputhje me sanksionimin e kryer në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”*, si dhe parashikimin e kryer në nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, se : *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*,

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave për mbështetjen e nevojshme financiare për ndërtimin e Ujësjellësit në Fshatin Visokë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia, Mallakastër.

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform parashikimit të në nenin 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Kopje të shkresës nr.1900/1 Prot, datë 04.11.2016, të Bashkisë, Mallakastër, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të preventivit të përgatitur dhe miratuar prej Bashkisë, Mallakastër, për Projektin “Furnizimi me ujë të pijshëm të Fshatit Visokë/ Ndërtimi i rrjetit shpërndarës”.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Konceptoi dhe Daktilografoi

A.Gjoleka